Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____ me cilësinë _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj se kam në proces dhe/ose jam shpallur fitues për kontratat e mëposhtme:

Nr.	Autoriteti kontraktor	Objekti i procedurës së prokurimit/kontratës	Vlera e shpallur fituese

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shënim: Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit duhet të plotësojë këtë deklaratë.

³Kjo deklarate ka si qëllim plotësimin e kriterit ligjor që operatori ekonomik brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nënkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura dhe/ose është shpallur fitues, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent

Shtojca 12

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Veç kësaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Përshkrimin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;*
- b. *Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 1/1;*
- c. *Sigurimoferte, (nëse është zbatueshme) sipas Shtojcës 3;*
- ç. *Deklaratëmbi përmbushjen e Specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;*
- d. *Deklaratëmbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;*
- dh. *Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës Shtojcës 8/1;*
- e. *Formular vlerësimi sipas Shtojcës 9;*
- f. *Deklaratëmbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 10;*
- g. *Deklaratë mbi kontratat e lidhura apo ne proces, sipas Shtojcës 11;*
- gj. *Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Për kapacitetin ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

Objekti i Ndertimit duhet të jetë i pasqyruar në ekstraktin e gjendjes aktuale të shoqërisë, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, në objektin e veprimtarisë së operatorit ekonomik.

2.2. Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:

a. Xhiro mesatare e realizuar nga Operatori Ekonomik gjate tre viteve te fundit (2017, 2018, 2019) duhet te mos jete jo me e vogel se 50% e vleres se fondit limit pa TVSH. Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti Operatori Ekonomik duhet te paraqese nje vërtetim nga Dega e Tatim Taksave për xhiron vjetore të realizuar në 3 (tre) vitet e fundit.

b. Operatori Ekonomik duhet te kete nje aktivitet pozitiv te qendrueshem gjate viteve 2017, 2018, 2019 Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti Operatori Ekonomik duhet te paraqese kopje të bilanceve të ketyre viteve, të paraqitura e konfirmuara nga autoriteti përkatëse, te shoqeruara nga akt ekspertiza e kryer nga Eksperti kontabel i autorizuar në përputhje me ligjin anr.10091 datë 5.3.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesi tligjor dhe kontabilistit të miratuar”

c. Operatori Ekonomik duhet te paraqese një deklaratë me shkrim nga administratori se subjekti ka paguar te gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, ne vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet per periudhen vitet 2019, 2020 sipas afateve te percaktuara ne ligjin 9632/2006 “Per sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. Kesaj deklaratë duhet ti bashkengjiten te gjithë vërtetimet qe deshmojne se operatori ekonomik ka paguar detyrimet perkatese, ne vendet ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet sipas QKR per kete periudhe, shoqeruara me mandatet perkates te pagesave

d. Operatori ekonomik nuk duhet të figurojë (-jone ne rast bashkimi OE) debitor ne institucioin e Ujesjelles Kanalizime sh.a. Delvine. Kjo eshte e vlefshme me nje vetedeklarime nga OE pjesemarese.

2.3 Për kapacitetin teknik:Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

2.3.1 Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën:

a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm të së njëjtës natyre në një vlerë jo më të vogël se 10% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet, të realizuar nga operatori ekonomik gjatë tri vitet të fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit.

ose

b. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit është në një vlerë jo më të vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e ben oferten të kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojes së suksesshme të Operatori/et Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori/et ekonomik duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm:
1. Formular vleresimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
 2. Kontratën/at e Sipërmarrjes
 3. Situacionin përfundimtar të objektit;
 4. Aktin e kolaudimit;
 5. Çertifikaten e marrjes në dorëzim;
 6. Faturat Tatimore për çdo situacion.

Formulari i vlerësimit duhet të përcaktoje saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, faktin nëse kontrata është realizuar me sukses, përqindjen e punimeve në rast bashkimi të shoqërive, etj.

- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori/et ekonomik duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm:
1. Formular vleresimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
 2. Kontratën/at e Sipërmarrjes;
 3. Situacionin përfundimtar të objektit;
 4. Çertifikaten e marrjes në dorëzim;
 5. Faturat Tatimore për çdo situacion.

Pika 2.3.1 gërma “a” plotësohet nga anëtarë i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 2.3.1 gërma “b” duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të ketë nje punësim mesatar të paktën 40 punonjës për periudhen **Qershor2020 –Nentor 2020**, e vërtetuar kjo me:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën **Qershor2020 –Nentor 2020**.
- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën **Qershor 2020 – Nentor 2020**, shoqëruar me formularet e deklaramit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

2.3.3 Për kapacitetin teknik:Operatorët ekonomike duhet të dëshmojnë se disponojnë liçense profesionale për zbatim punimesh në ndërtim si dhe në liçense disponojnë kategorite e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet tëparaqesin liçensën përkatëse të shoqërise, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr.42 datë 16.01.2008; *Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale tëzbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi*”, i ndryshuar.

Licensa profesionale e Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

- **Për punimet e përgjithshme të ndërtimit kompania duhet të ketë liçensat e mëposhtme:**

1. NP 1 – B Punime gjurmimi në tokë;
2. NP 2 – A Ndërtime civile dhe industrial;
3. NP 4 – B Rrugë,autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale;
4. NP 7 – C Ujësjellësa, gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje;
5. NP 9 - A Punime dhe mbrojtje lumore sistemime hidraulike dhe bonifikime;
6. NP 11 - A Ndërtime për nënstacione, kabinat e transformatorëve, etj.
7. NP 12 – A Punime të inxhinierisë së mjedisit.

- **Për punimet speciale të ndërtimit duhet të ketë liçensat e mëposhtme:**

1. NS 4 –B Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me infrastrukture druri, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndertuese;
2. NS 14 - A Impiante te brendeshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TVeij;
3. NS18 – A Punime topogjeodezike;
4. NS 19 – A Sistemet kundra zhurmes per infrastructure;
5. NS 20– A Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime për ujë.

sipas modelit të lëshuar nga MPPT.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzoj liçensat profesionale sipas zërave të preventivit që në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit merr përsipër të realizojë).

Shoqëritë e huaja duhet të kenë kryer ekuivalentimin (njehsimin) e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturs dhe Energji, Republika e Shqipërisë, siç përcaktohet tek *”Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojnë veprimtari ndertimi, e miratuar me VKM Nr.42, date 16.01.2008”*.

2.3.4 Staf kryesor e mbështetës, punonjesit, çertifikimet

Dokumenta Standarde të Tenderit

“Rikonstruksioni i rrjetit të jashtëm (furnizimit) dhe rrjetit të brendshëm (shpërndarjes) të ujësjellësit të fshatit Vanë”

- a. Operatori/et ekonomike ofertues duhet të ketë në stafin e tij si drejtues teknik dhe ne licencën e shoqërisë inxhinierët e mëposhtëm: Inxhinier Hidroteknik:1 (nje); Inxhinier Elektrik: 1 (një); Inxhinier Topograf:1 (nje); Inxhinier Gjeolog:1 (një) dhe Inxhinier Mjedisi me profil për trajtimin e ujerave: 1 (një). Inxhinieret e sipërcituar duhet të figurojnë si drejtues teknik në licencën e operatorit ekonomik ofertues. Për secilin duhet të paraqiten: Kontratë pune e noterizuar (e vlefshme), Diploma, CV dhe Libreze pune.
- b. Operatori/et ekonomike ofertues duhet të ketë në stafin e zbatimit inxhinierët e mëposhtëm: Inxhinier ndertimi:1 (nje), i kualifikuar/ certifikuar me Certifikatë Trajnimit “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr.10327 date 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe VKM Nr. 312 datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”, Inxhinier Elektronik (nje) dhe Inxhinier Mjedisi: 1 (një), i pajisur me certifikatë të lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit ne Mjedis.Për secilin nga keta duhet të paraqiten: Kontratë pune e noterizuar (e vlefshme), Diploma, CV dhe Libreze pune.

Operatori Ekonomik duhet të deklarojë me shkrim se inxhinieret e kërkuar në pikën 2.3.4, a dhe b janë të paangazhuar në kontrata të tjera.

- c. Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/ certifikuar jo më pak se 9 (nente) punonjës të kualifikuar ne profesionet e punimeve që parashikon preventive si punonjës ndertimi 1 (nje), hidraulik 2 (dy), bojaxhi 1 (nje), mekanik 1 (nje), mirembajtës 2 (dy), elektriciste 2 (dy) të pajisur me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve, në bazë të Ligjit Nr.8734, datë 01.02.2001 dhe Ligjit Nr. 13/2013. Për të cilët duhet të paraqiten: Dëshmi Kualifikimi për Aftësimin Teknik.
- d. Operatori/et ekonomike ofertues duhet të ketë në stafin e tij **1 (një) mjek** në bazë të paragrafit 12/2 të VKM Nr. 692, datë 13.12.2001 “Për Masat e Vecanta të Sigurimit dhe Mbrojtjes së Shëndetit në Punë, i ndryshuar dhe të Ligjit Nr.10237, datë 18.02.2010 ”Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, VKM Nr.108, datë 9.2.2011 ”Për aftësi që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë” (i ndryshuar). Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej operatorëve që plotëson kriteret e VKM 742 datë 06.11.2013, duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) mjek të përgjithshëm. Për të cilin duhet të paraqiten: Kontratë pune e noterizuar (e vlefshme), Diploma, Urdhër Mjeku, CV, Libreze pune sidhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë.
- e. Operatori/et ekonomike ofertues duhet të jetë I pajisur me:

Licencë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit (QKB): Kodi I.2.A “Sherbime ekspertize dhe ose profesionale të mbrojtjes civile” për të siguruar mbrojtje të vepres hidrike, të pajisjeve që do të instalohen në këto vepra dhe për mbrojtjen e njerezve nga zjarri gjatë procesit të zbatimit të kontratës.

Licencë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit (QKB): Kodi II.8.B “Sherbime nderhyrese higjieno-sanitare: Dezinfektim, Deratizim, Dezinsektim”, për të siguruar një shërbim

higjieno sanitar dezinfektimi ne cdo object e nenobjekt te kontartes se ujesjesjellesit te rrjetit kryesor dhe sekondar qe do te rikonstruktohet;

Liçencë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit (QKB): Leje mjedisore kodi III.1.A, e tipit “C” për “Pastrim i rrugëve dhe i mjedisit nga mbetjet e ngurta urbane, te qytetit dhe qendrave dhe seleksionimi tyre sipas përberjes”, per te siguruar nje mjedis te paster nga mbetjet e formuara gjate procesit te zbatimit te kontrates se ujesjesjellesit te rrjetit kryesor dhe sekondar qe do te rikonstruktohetdhe ne kushtet e egzistences se pandemise se koronavirusit COVID 19 ne vend;

Liçencë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit (QKB): Kodi III.2.A “Sherbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin ne mjedis”, per ekspertize te lidhur me ndikimin ne mjedis gjate zbatimit te kontrates se ujesjesjellesit te rrjetit kryesor dhe sekondar qe do te rikonstruktohetdhe ne kushtet e egzistences se pandemise se koronavirusit COVID 19 ne vend.

Liçense te leshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit (QKB): Kodin III.2.B “Grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, perpunim dh asgjesim I mbetjeve te llojeve te ndryshme (urbane) per te siguruar nje mjedis te paster teresor gjatezbatimitte kontrates se ujesjesjellesit te rrjetit kryesor dhe sekondar qe do te rikonstruktohetdhe ne kushtet e egzistences se pandemise se koronavirusit COVID 19 ne vend.

Liçense e leshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit(IQKB): Kodi III.7.A “Sherbime profesionale per projektme. Sherbime profesionale per zbatime” per shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me pyjet gjate procesit te realizimit te zbatimit te kontrates se ujesjesjellesit te rrjetit kryesor dhe sekondar qe do te rikonstruktohet, per zbatimin e kontrates dhe ne kushtet e egzistences se pandemise se koronavirusit COVID 19 ne vend.

Liçense e leshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit(IQKB): Kodi III.7.3.B.1.a.b.c.ç“Sherbime ekspertize dhe/ose profesionale te lidhura me transportin rrugor”, autoriparimi I mjeteve per te siguruar nje sherbim riparimi te mjeteve qe do te meren me realizimin e kontratese ujesjesjellesit te rrjetit kryesor dhe sekondar qe do te rikonstruktohet.

Për të gjitha keto duhet të paraqiten: formatet perkatese te licencave

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar I grupit duhet të dorëzoj liçensat profesionale sipas zërave të preventivit që në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit qe merr përsipër të realizojë).

- f. Kandidati ofertues duhet të përcaktoje me anë të një deklaratë (nga Administratori I shoqërisë) se Drejtuesi Teknik I punimeve në object do të jetë I përfshire në licensën e shoqërise, me vjetërsi pune mbi 10 vjet dhe të deklaroje se ai do të jetë I pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në object, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtem: Kontratë pune e noterizuar (e vlefshme), Diploma, CV, Libreze pune (përkatëse).
- g. Operatori / et ekonomik ofertues duhet të paraqesin Certifikatën e cilësisë së punimeve:

¹EN-ISO 9001 (Sistemi i menaxhimit të cilësisë) (me certifikate akreditimi).

Dokumenta Standarde të Tenderit

“Rikonstruksioni i rrjetit të jashtëm (furnizimit) dhe rrjetit të brendshëm (shpërndarjes) të ujësjellësit të fshatit Vanë”

²EN-ISO 14001 (Sistemi i menaxhimit të mjedisit) (me certifikate akreditimi).

³BS OHSAS 18001 / 45001 (Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë) (me certifikate akreditimi).

⁴BS PAS 99 (Sistemi i menaxhimit të integruar).

⁵ISO 22301 (Sistemi i menaxhimit të vazhdimësisë së biznesit);

⁶ISO 39001 (Certifikate për sistemin e menagjimit të sigurisë në trafikun rrugor);

⁷ISO 50001 (Certifikate për sistemin e menagjimit të energjisë);

Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

(Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë përkatësisht Çertifikatën ISO sipas zerave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).

h. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht 2 (dy) punonjës shofere. Për këto punonjës duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmitë e drejtimit (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë.

i. Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 10).

Mjetet	Sasia	Gjendja
Kamionavetshkarkues peshe neto 2.83 ton	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamionavetshkarkues peshe neto 4.4 t	1 copë	Pronësi ose me qera
Fadrome 6 t	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamioncine peshe neto 2.3 t	1 copë	Pronësi ose me qera
Minieskavatore	1 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator	3 copë	Pronësi ose me qera
Nyje prodhimi inert vetelevizese	1 copë	Pronësi ose me qera
Rul ngjeshes 9 ton	1 copë	Pronësi ose me qera
Pajisje saldimi tubosh polietileni koke me koke	1 copë	Pronësi ose me qera
Pajisje saldimi tubosh polietileni elektrovulsive	1 copë	Pronësi ose me qera
Pompë uji 150 kva	2 copë	Pronësi ose me qera
Depozite Uji 5000 lit	2 copë	Pronësi ose me qera
Autobot Uji peshe neto 7.8 t	1 copë	Pronësi ose me qera
Vibrator sipërfaqesor dhe thellesie	2 copë	Pronësi ose me qera
Makineri levizese dheu me kompresor dhe ngarkues dherash	1 copë	Pronësi ose me qera
Gjenerator energjie elektrike 270 kva	2 cope	Pronësi ose me qera
Motor betoniere 300 litershe	2 copë	Pronësi ose me qera
Sonde Shpimi (me goditje) “UKS”, me diameter 600 mm	1 copë	Pronësi ose me qera
Carico sul piastra (kriko mbi pjaster) pompe hidraulike dhe radial qe mat shkallen e ngjeshmerise se shtreses se mbushjes se kanalit, me inxhinjer te licencuar laboratory dhe me foto te	1 complet	Pronësi ose me qera

Dokumenta Standarde të Tenderit

“Rikonstruksioni i rrjetit të jashtëm (furnizimit) dhe rrjetit të brendshëm (shpërndarjes) të ujësjellësit të fshatit Vanë”

pajisjes.		
<p>Nyje Prodhimi ose Kontrate Furnizimi me qera me inerte me mjetet dhe pajisjet e meposhtme: Sonde Shpimi, Mjet Germimi Eskavator, Mjet Ngarkimi Fadrome, Kompresor Ajri dhe Konvertues Energjie Per te cilen duhen te jene pajisur:</p> <p>a) Me leje per perdorim civil te lendeve plasese dhe me person te pajisur me deshmi zjarrmetari, b) Me III.1.B Leje mjedisore e tipit B per “Impiant fraksionimi te inerteve te gurit gelqeror” c) Me leje mjedisore Kodi IV.B.2 “Leje minerale shfrytezimi guri gelqeror” d) Me leje mjedisore Kodi III.1B ‘Nxjerja mineraleve reres argjiles nga mineralet ne qiell te hapur dhe nga gurroret”, <i>te gjitha me afat vlefshmerie, brenda kohes se zbatimit te projektit dhe ne largesi deri 12 km nga kantjeri ndertimit te objektit Fshati Vane</i></p>	1 complet	Pronësi ose me qera

Të paraqiten mjetet dhe pajisjet e mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore minimumi 40 copë.
- Rripa lidhës sigurimi minimumi 40 copë.
- Fikëse zjarri minimumi 40 copë.
- Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 40 copë.
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 60 copë.

Eshtë e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës nr. 10 dhe dokumentacioni si më poshtë:

- a) Për mjetet me rrota që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit.
- b) Për mjetet e siguruar me qera, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, duhet të shoqërohet me kontratën noteriale të qerave e lidhur për këtë objekt, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.
- c) Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij.
- d) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr. 10. (Deklaratë nga përfaqesuesi i shoqërisë ofertuese).
- e) Operatori/et ekonomik ofertues duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përshkruara më sipër të Kapacitetit Teknik do të jenë të angazhuara vetëm në këtë kontratë. Mjetet të cilat

Dokumenta Standarde të Tenderit

“Rikonstrukcioni i rrjetit të jashtëm (furnizimit) dhe rrjetit të brendshëm (shpërndarjes) të ujësjellësit të fshatit Vanë”

rezultojne të angazhuara në kontrata të tjera afati i zbatimit të cilave shtrihet përgjate afatit të kontratës objekt i prokurimit janë shkak s'kualifikimi. Autoriteti Kontraktor gëzon të drejten të verifikojë dhe kontrollojë disponueshmërinë e këtyre mjeteve si gjatë vlerësimit të ofertave ashtu edhe gjatë zbatimit të kontratës.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejten të verifikojë vërtetësinë e deklaratës. Në rast deklarimi të rreme do të veprohet në përputhje me nenin 13, pika 3, germa ”a” të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, “Për Prokurimin Publik”.

Kandidatët/ofertuesit duhet të përmbushin kërkesat ligjore të parashikuara në nenin 45 të Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 ”Për prokurimin publik”i ndryshuar. Në rastin e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, kandidatët/ofertuesit duhet t'i përmbahen VKM-së nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Operatoret e huaj ekonomikë, duhet të paraqesin të gjithë dokumentacionin e tyre në gjuhën shqipe (si gjuhë e ofertës), të bëjnë noterizimet përkatëse si dhe të jenë të certifikuara “Apostille”. Për vendet që nuk kanë ratifikuar Konventën e Hagës datë 5 tetor 1961, “Për heqjen e kërkesës për legalizim diplomatik e konsullor të dokumenteve zyrtare të huaja”, duhet të bëhen legalizimet në ambasadat, konsullatat ose zyrat respektive nga vendi i origjinës. (Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues).

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shtojca 13

(Shtojcë për t’u plotësuar nga autoriteti kontraktor)

PROJEKTI I ZBATIMIT DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE

Përshkrimi i të dhënave teknike tëpunëve objekt prokurimi të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Skicimet, Planimetritë e Objektivit etj:**sipas dokumentave bashkelidhur.**

Specifikimet Teknike tëMaterialeve:**sipas dokumentave bashkelidhur.**

Grafiku i Punimeve:**sipas dokumentave bashkelidhur.**

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shtojca 14

(Shtojcë për t’u plotësuar nga autoriteti kontraktor)

PREVENTIVAT E PUNIMEVE

Sipas dokumentave bashkelidhur.

Shtojca 15

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDART PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR⁴

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar Z. /Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 Për Prokurimin Publik.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s’kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në Kreun VII të LPP-së.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt
< **Emri** >

⁴ Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore

Shtojca 16

[Shtojcë për t'u plotësuar Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TËFITUESIT

[Data_____]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Dokumenta Standarde të Tenderit

“Rikonstrukcioni i rrjetit të jashtëm (furnizimit) dhe rrjetit të brendshëm (shpërndarjes) të ujësjellësit të fshatit Vanë”

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]/pikët totale të marra [_____] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 17

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____
2. _____
3. _____

* * *

Procedura e prokurimit: _____

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti, kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomikisht më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatoren e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____

Dokumenta Standarde të Tenderit

“Rikonstrukcioni i rrjetit të jashtëm (furnizimit) dhe rrjetit të brendshëm (shpërndarjes) të ujësjellësit të fshatit Vanë”

Emri i plotë i shoqërisë _____

numri i NIPT-it _____

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë _____

numri i NIPT-it _____

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë _____

numri i NIPT-it _____

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë _____

numri i NIPT-it _____

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 18

KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS Punët – Procedura e Hapur

Neni 1: Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Punëve të prokuruarra ne bazë të legjislacionit të prokurimit.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e parashikuara në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “Preventiv total” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt te cilat jane orientuese, plotësuar me cmimin total të përcaktuar që është pjesë e Ofertes në një kontratë me çelsa ne dore.
- 2.2 “Preventiv per njesi” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt shoqeruar me cmimet per njesi te pandryshuara që janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime ne matje.
- 2.3 “Afati i realizimit te punimeve” do të thotë data që Punët duhet të perfundojnë siç është shprehur në Grafikun për realizimin Punimeve , e vertetuar nga enti prokurues.
- 2.4 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.5 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet kontraktorit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.

Dokumenta Standarde të Tenderit

“Rikonstruksioni i rrjetit të jashtëm (furnizimit) dhe rrjetit të brendshëm (shpërndarjes) të ujësjellësit të fshatit Vanë”

- 2.6 “Realizimi i punimeve” do të thotë data e vërtetuar nga Autoriteti Kontraktor se Punët janë mbaruar.
- 2.7 “Defekt” do të thotë çdo pjesë e Punimeve e paperfunduar në përputhje me kontratën.
- 2.8 “Data e hyrjes” do të thotë data që Autoriteti Kontraktor lejon kontraktorin në kantier.
- 2.9 “Data e fillimit” është përfshirë në Të dhënat e kontrates. Ajo është data kur kontraktori do të fillojë punimet e ndertimit. Nëse kjo nuk realizohet, “data e fillimit” do të jetë dita në të cilën do të paguhet paradhënia.
- 2.10 “Pajisje” do të thotë makineritë dhe veglat e kontraktorit të sjella përkohësisht në kantier për realizimin e Ndertimeve.
- 2.11 “Materiale” do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga kontraktori për kryerjen e punimeve.
- 2.12 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Punët që kontraktori do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.13 “Palë(t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.14 “Drejtues projekti” do të thotë personi i emëruar nga Autoriteti Kontraktor që është përgjegjës për administrimin e kontratës për Autoritetin Kontraktor.
- 2.15 “Autoritet Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe që kontraktori punon objekt i kësaj kontrate. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.16 “Kantier” do të thotë vendi fizik i Punimeve.
- 2.17 “Raport i inspektimit të kantierit” do të thotë dokumentat e përfshira në dokumentat e tenderit që pasqyrojnë informacion faktik dhe të interpretuar rreth kushteve të sipërfaqes dhe nëntokës së kantierit.
- 2.18 “Nënkontraktues” do të thotë çdo person fizik ose ligjor ose kombinim i mësipërm, që furnizon Punët, materialet ose pajisjet për ose në emër të kontraktorit.
- 2.19 “Kontraktor” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Punimet.
- 2.20 “Standarte Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarte të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.
- 2.21 “Ngritja e kantierit” do të thotë punimet e ndertimit të përkohshme, të ndërtuara e instaluar, që janë të nevojshme për zbatimin e punimeve të ndërtimit.

- 2.22 “Punime” do të thotë ajo që Autoriteti Kontraktor i kërkon nga kontraktori të gërmojë, ndërtojë, riparojë, rinovojë ose instalojë siç parashikohet në dokumentat e tenderit duke përfshirë shërbimet në lidhje me to, gjithashtu të përkufizuara në dokumentat e tenderit.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.
- 3.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke sanksionuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikrat e Korrupsionit, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se kontraktori ka kryer veprime të korrupsionit. Veprimet e korrupsionit përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktori nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ent që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktori duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 5: Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktori dhe Autoriteti Kontraktues duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktori mund t’i japë nënkontraktorit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar që nënkontraktorin të zbatojë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, kontraktori duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktorin një dispozitë që premtim ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6: Prona Intelektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruar nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës do t’i përkasin Autoritetit Kontraktor i cili mund t’i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori, pas përfundimit të kontratës, duhet t’i dorëzojë Autoritetit Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktori mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t’i përdori për qëllime që s’kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.

- 6.3 Kontraktori duhet të garantojë Autoritetin Kontraktor zhveshjen nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale, që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas kontratës, kontraktori duhet t’i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të kontraktorit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7: Origjina e Materialeve

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktori mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e materialeve.
- 7.3 Për qëllime verifikimi “origjinë” do të thotë vendi ku materialet janë nxjerrë, bashkuar ose prodhuar. materialet janë prodhuar kur, nëpërmjet prodhimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- 7.4 Origjina e materialeve ka dallim nga kombësia e kontraktorit ose nënkontraktorit që furnizon me materiale.

Neni 8: Vendimet e Drejtuesit të Projektit

- 8.1 Drejtuesi i projektit do të vendosë për çështjet e kontratës midis kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor
- 8.2 Drejtuesi i Projektit mund të delegojë ndonjë nga detyrat dhe përgjegjësitë e tij tek të tjerët përveç zgjidhjen e mosmarrveshjeve dhe konflikteve. Drejtuesi i projektit duhet të njoftojë kontraktorin për delegimet e bëra apo të revokuara.

Neni 9: Komunikimi

- 9.1 Çdo komunikim midis palëve duhet të bëhet me shkrim.

Neni 10: Bashkëpunimi në Kantier me të Tjerët

- 10.1 Kontraktori duhet të bashkëpunojë dhe të ndajë kantierin me firma të tjera, autoritete publike, shërbimet publike dhe Autoritetin Kontraktor siç kërkohet dhe përkufizohet në Grafikon e realizimit të punimeve.

Neni 11: Përgjegjësia e Autoritetit Kontraktor

- 11.1 Autoriteti Kontraktor ka përgjegjësi të kompensojë kontraktorin për dëmtime të pajisjeve të kontraktorit deri në masën që lidhet me veprime me faj të Autoritetit Kontraktor ose të

projekteve të Autoritetit Kontraktor me përjashtim të rastit kur keto të fundit, kishin gabime të dukshme që mund të ishin konstatuar lehtësisht nga kontraktuesi.

Neni 12: Raporti i Inspektimit të Kantierit dhe Kushtet e Kantierit

- 12.1 Autoriteti Kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi për konkluzionet ose interpretimet e bëra në raportin e inspektimit të kantierit.
- 12.2 Kontraktori pranon se i ka marrë të gjitha hapat e nevojshme për të verifikuar natyrën dhe vendin e Punimeve dhe se ka inspektuar dhe pajtohet me kushtet e përgjithshme dhe lokale që mund të ndikojnë në kryerjen ose koston e Punëve.

Neni 13: Kontraktori që Kryen Punimet

- 13.1 Kontraktori duhet të kryejë dhe mbarojë Punimet në përputhje me specifikimet teknike të paraqitura në dokumentat e tenderit.
